

DEKRET
Nr. 3057, date 18.2.1960

MBI
DISA NDRUSHIME NE LIGJEN NR. 1763 DATE 26 1953
<<MBI KESHILLAT POPULLORE>>

Ne mbeshtetje te nenit 58,pika 6,te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Nxjerr kete dekret;

Dekret mbi disa ndryshime ne ligjen nr.1763 date 26-11-1953<<mbi keshillat popullore>>

Neni 1

Ne paragrafin e I-re te nenit 2 te ligjes Mbi keshillat popullore fjalet e fundit <<rrethet dhe qarqet>> zevendesohen me fjalet <<dhe rrethet>>.

Neni 2

Ne paragrafin e I-re te nenit 3 te ligjes Mbi keshillat popullore fjalet «rretheve dhe qarqeve» zevendesohen me fjalet <<dhe rretheve>>

Neni 3

Neni 7 i ligjes Mbi keshillat popullore, ndryshohet ne «Keshilla popullore qyteti krijohen ne vendet e banuara qe formojne qytete.

Qytetet me te medha mund te njesohen me lokalitetin ose rrethin.

Qytetet e medha mund te ndahen ne lagje me ne krve keshillat popullore te lagjeve».

Neni 4

Neni 10 i ligjes Mbi keshillat popullore bie nga fuqia.

Neni 5

Neni 11 i ligjes Mbi keshillat popullore sic eshte ndryshuar retet Nr. 1882 date 21-6-1954 dhe Nr. 1973 date 13-12-1954 ndryshohet ne kete menyre:

"Deklarimi i nje vendi te banuar si fshat ose qytet dhe I nje fashati qytet, ckeputja e nje vendi te banuar qe ka me shume se 10 shtepi nga nje fshat ose qytet dhe bashkimi me nje tjeter,ndryshimi I qendres si dhe ndryshime se lokalitetit, ndryshimi i emerave te fshatrave, qyteteve sidhe ndryshimet e tjera ne lidhje me formimin e ketyre njesive administrative, behen me dekret te Presidiumit te Kuvendit Popullor mbi propozimin e keshillit popullore te rrethit perkates:

Krijimi dhe suprimimi i lokahteteve dhe rretheve dhe ndryshime

e tjea per formimin e njesive administrative te rretheve ngritja e qyteteve ne shkalle rrethi sidhe krijimi dhe suprimi i lagjeve te qyteteve te behet me dekret te Presidiumit te Kuvendit Popullor mbi propozimin e keshillit te ministrave.Ckeputja e nje vendi te vogel te banuar (10 shtepi e poshte)nga nje fshat ose qytetdhe bashkimi me nje tjeter behet me vendim te keshillit popullore te rrethit.

Neni 6

Neni 12 I ligjes Mbi keshillat Popullore sic eshte ndryshuar me dekretin nr. 2113 date 8-8-1955. ndryshohet ne kete menyre:

Konfliktet per kufijte tokesore midis dy fshatrave ose dhe qytetit ose lagjeve te qyteteve. ose midis dy lokaliteteve po te te njejtit rreth. zgjidhen nga keshilli popullor i rrethit perkates ndersa kur keta njesi administrative jane te rretheve te ndryshme zgjidhen nga _ Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Neni 7

Neni 21 i ligjes Mbi keshillat popullore, ndryshohet ne kete menyre:

Permbajtja e bisedimeve dhe vendimet e marra prej keshillit popullor shkruhen ne procesverbalin e mbledhjes.

Procesverbali neneshkruhet nga kryetari dhe sekretari i keshillit popullor.

Kopja e procesverbalit te keshillit popullor te rrethit i dergohet Presidiumit te Kuvendit Popullor dhe Keshillit te Ministrave dhe ato te keshillave popullore te tjera komitetit ekzekutiv te keshillit popullor menjehere me te larte».

Neni 8

Neni 28 I ligjes Mbi keshillat popullore, ndryshohet ne kete menyre: <<Organet ekzekutive dhe urdher-dhenese te keshillave popullore jane

Komitetet ekzekutive qe zgjidhen nga keshillat popullore.

Komitetet ekzekutive te keshillave popullore te rretheve perbehen nga 9 ne 13 anetare duke perfshire ne kete numur. kryetarin, zevendezin e tij dhe sekretarin.

Komitetet ekzekutive te keshillave popullore te lokaliteteve, te qyteteve dhe lagjeve te qyteteve perbehen nga kryetari, sekretari dhe nga 3-7 anetare..

Fshatrat qe kane me shume se 10 anetare keshilli, me vendim te keshillit popullor te rrethit, mund te krijohen komitete ekzekutive te perbera nga kryetari, sekretari dhe 1 deri 3 anetare. Ne fshatrat qe kane me pak se 10 anetare keshilli. detyrat e organit ekzekutiv i kryejne kryetari dhe sekretari i keshillit popullor.

Numuri i anetareve per cdo komitet ekzekutiv te keshillave popullore te rretheve caktohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe per komitetet ekzekutive te tjera te caktohet nga keshilli popullor menjehere me te larte.

Neni 9

Neni 36 i ligjes Mbi keshillat popullore, ndryshohet ne kete menyre <<Prane komiteteve ekezekutive te keshillave popullore mund te krijohen seksione dhe zyra sipas llojit te veprimtarise se tyre».

Seksionet dhe zyrat prane komiteteve ekzekutive te keshillave popullore si dhe kopetencat tyre e caktohen me dispozita te Qeverise>>

Neni 10

Neni 38 I ligjes mbi keshillat popullore ndryshohet ne kete menyre: Emerimi I shefave te seksioneve dhe te zyrave te komiteteve ekzekutive te behet nga keshilli popullor ndersa emerimi I nepunesve te tjere behet sipas rregullave te pergjithshme te vendosura nga keshilli I Ministrave.

Si shefa te seksioneve dhe te zyrave mund te emerohen edhe persona qe nuk jane anetare te komitetit ekzekutiv ose te keshillit popullor.

Neni 11

Neni 49 i ligjes Mbi keshillat popullore ndryshohet si vijon:

<<Keshillat popullore dhe komitetet ekzekutive ne lidhje me ceshtjen qe jane ne kompetencen e tyre, kane te drejte te nxjerrin dispozita ne forme vendimesh, ose urdheresash, per shkeljen e te cilave te parashikojne denime administrative.

Denimet qe mund te parashikohen per keto shkelje dhe gjykimit te tyre caktohen me dekretin mbi kundravajtjet>>

Neni 12

Neni 53 i ligjes Mbi keshillat popullore, ndryshohet ne kete menyre «Rregulloret per funksionimin e brendeshem te komiteteve e te te gjitha keshillave popullore, hartohen nga komiteti ekzekutiv popullor perkates dhe aprovohen nga organi ekzekutiv menjehere me i larte».

Neni 13

Ky dekret hyn ne fuqi menjehere.

Tirane, me 18 shkurt 1960

Dekret Nr. 3057

PER PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TE REPUBLIKES POPULLORE TE SHQIPERISE

SEKRETAR
Sami Baholli

KRYETAR
Haxhi Lleshi